

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**  
**MISIONI NË KOSOVË**

**Mirëmbajtja e varrezave ortodokse në Kosovë**

**Shtator, 2011**

*Mohim përgjegjësie:*

Versioni i këtij publikimi në gjuhën angleze është versioni zyrtar. Gjitha versionet e këtij publikimi në gjuhët tjera janë përkthim nga versioni origjinal në anglisht, si dhe nuk janë dokumente zyrtare.

## **PËRMBAJTJA**

<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....</b>	<b>3</b>
<b>1. HYRJJE .....</b>	<b>4</b>
<b>2. METODOLOGJIA .....</b>	<b>5</b>
<b>3. ROLI DHE RËNDËSIA E VARREZAVE NË FENË ORTODOKSE SERBE.....</b>	<b>6</b>
<b>4. GJENDJA FIZIKE E VARREZAVE ORTODOKSE .....</b>	<b>7</b>
<b>5. FAKTORËT QË KONTRIBUOJNË NË GJENDJEN E VARREZAVE ORTODOKSE.....</b>	<b>8</b>
5.1 GJENDJA E VARREZAVE ORTODOKSE SIPAS AFËRSISË APO LARGËSISË NGA KOMUNITETI SERB I KOSOVËS .....	8
5.2 GJENDJA E VARREZAVE ORTODOKSE SIPAS AFËRSISË APO LARGËSISË NGA FSHATI.....	9
<b>6. MIRËMBAJTJA E VARREZAVE ORTODOKSE .....</b>	<b>10</b>
6.1. PËRGJEGJËSITË E KOMUNAVE.....	10
6.1.1 <i>DISPOZITAT LIGJORE</i> .....	11
6.1.2 <i>BUXHETI</i> .....	11
7. ROLI I AKTERËVE TJERË .....	13
7.1. KONTRIBUTET E KOMUNITETIT SERB TË KOSOVËS .....	13
7.2. KONTRIBUTET E KISHËS ORTODOKSE SERBE (KOS).....	13
7.3. KONTRIBUTI I HISEDARËVE TJERË .....	13
7.3.1 <i>MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM</i> .....	13
7.3.2 <i>KOMISIONI PËR IMPLEMENTIMIN E RINDËRTIMIT PËR TËRËSITË RELIGJIOZE ORTODOKSE SERBE NË KOSOVË</i> .....	14
7.3.3 <i>MINISTRIA PËR KOSOVË DHE METOHI E REPUBLIKËS SË SERBISË</i> .....	14
8. <i>AKTIVITETET E MISIONIT TË OSBE-së NË KOSOVË</i> .....	14
<b>9. PËRFUNDIM .....</b>	<b>14</b>
<b>10. REKOMANDIMET.....</b>	<b>15</b>
<b>SHTOJCA I: PASQYRË E STATUTEVE DHE E RREGULLOREVE KOMUNALE PËR MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE .....</b>	<b>16</b>

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet një pasqyrë të gjendjes, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së varrezave ortodokse serbe në Kosovë. Ai është përfundimi i një vlerësimi të kryer nga Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) gjatë periudhës qershor-korrik 2010 dhe është menduar të lexohet në ndërthurje me Katalogun e Fotografive të Varrezave Ortodokse të publikuar nga ana e OSBE-së.<sup>1</sup> Gjersa Katalogu i Fotografive është regjistër i gjendjes fizike të 392 varrezave ortodokse të hulumtuara nga OSBE-ja, ky publikim analizon arsyet e gjendjes së keqe të shumicës së këtyre varrezave dhe ofron rekomandime për përmirësimin e tyre.

Ky raport thekson se gjendja përgjithësisht e keqe e varrezave ortodokse në Kosovë është në masë të madhe rrjedhojë e përdhosjes së përhapur të monumenteve fetare që ndodhi pas konfliktit të vitit 1999 dhe trazirave të marsit 2004. Veç kësaj, shumë varreza ortodokse janë përdhosur për shkak se popullata serbe e Kosovës, e cila tradicionalisht i kishte shfrytëzuar dhe mirëmbajtur ato, është zhvendosur si pasojë e konfliktit dhe deri më sot nuk janë kthyer në shtëpitë e tyre të mëhershme. Raporti vlerëson se faktori më i rëndësishëm që ka kontribuar në gjendjen e mirë të varrezave ortodokse është prania e komunitetit serb të Kosovës në fshatrat në afërsi të varrezave.

Ky raport analizon përgjegjësitë e komunave në mirëmbajtjen e varrezave, posaçërisht obligimet e tyre ligjore sipas statuteve komunale dhe/apo rregulloreve komunale, duke nënvizuar dështimin e shumicës së komunave për të ndarë buxhete specifike për mirëmbajtjen e varrezave ortodokse. Vlen të theksohet se edhe atëherë kur komunat kryejnë punë mirëmbajtjeje, tendencat janë që ato bëhen në mënyrë *ad hoc* dhe vetëm për një numër të vogël të varrezave ortodokse. Gjithashtu, ky raport tregon se komuniteti serb i Kosovës dhe Kisha Ortodokse Serbe (KOS) kanë luajtur rolin më të rëndësishëm në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e varrezave, veçanërisht përmes mobilizimit të vullnetarëve lokalë. Në fund, raporti shqyrton shkurtimisht rolin e hisedarëve të tjerë, përfshirë Komisionin për Implementimin e Rindërtimit për Tërësitë Religjioze Ortodokse në Kosovë (KIR),<sup>2</sup> Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Serbisë për Kosovë dhe Metohi dhe OSBE-në, në restaurimin dhe mirëmbajtjen e varrezave ortodokse në Kosovë.

Me qëllim të dhënies së kontributit për krijimin e kushteve të përshtatshme për kthimin e të gjithë personave të zhvendosur dhe për dialogun ndërmjet komuniteteve, ky raport i rekomandon të gjitha komunave që të ndajnë më tepër burime financiare për mirëmbajtjen e varrezave ortodokse, dhe i bënë thirrje të gjitha institucioneve relevante dhe bashkësisë ndërkombëtare që të inkurajojnë dhe mbështesin komunat në përmirësimin e gjendjes dhe mirëmbajtjen e varrezave ortodokse, në veçanti në komunat që kanë prestarë të komunitetit serb të Kosovës dhe në vendet e potenciale të kthimit.

---

<sup>1</sup> Shih "Katalog i Fotografive – Varrezat Ortodokse në Kosovë", Misioni i OSBE-së në Kosovë, shtator 2011.

<sup>2</sup> KIR është projekt i financuar nga Bashkimi Evropian i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian dhe i zbatuar nga Këshilli i Evropës. Për më shumë informata për KIR-në, vizitoni <http://www.KIRkosovo.org/> (qasur më 21 mars 2011).

## 1. HYRJE

Përdhosja e përhapur e monumenteve të trashëgimisë fetare, përfshirë varrezat ortodokse, ndodhi pas konfliktit të vitit 1999 dhe trazirave të marsit 2004. Ende ndodhin akte të vandalizmit që kanë për cak varrezat ortodokse, ndonëse tani shumë më rrallë sesa në të kaluarën.<sup>3</sup>

Gjersa disa nga varrezat e përdhosura tani janë riparuar dhe restauruar, shumë prej tyre ende janë në gjendje të keqe. Gjatë vlerësimit të kryer në qershor dhe korrik 2010, OSBE-ja gjeti se më shumë se 200 varreza ortodokse dhe më shumë se 500 gurë varresh janë dëmtuar apo vandalizuar.<sup>4</sup>

Komisioni për të drejta të njeriut të OKB-së përmes Raportuesit Special për Lirinë e Fesë dhe Besimit,<sup>5</sup> nje përdhosjen e varrezave si shkelje të së drejtës së lirisë së të menduarit, ndërgjegjes dhe fesë<sup>6</sup>. Gjithashtu, Komisarari për të Drejta të Njeriut i Këshillit të Evropës ka dënuar përdhosjen e varrezave fetare si shkelje të së drejtës së lirisë së të menduarit, ndërgjegjes dhe fesë, sipas nenit 9 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.<sup>7</sup> Në Kosovë, dy varreza janë propozuar për tu përfshirë në Ligjin për Trashëgimi Kulturorë.<sup>8</sup>

Mirëmbajtja e shumicës së varrezave, sipas ligjit, është detyrë e komunave. Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë, komunat janë përgjegjëse për “Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave.”<sup>9</sup> Përderisa Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale përmend vetëm “sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike dhe hapësirave”,<sup>10</sup> ai gjithashtu thekson se komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në

<sup>3</sup> Në periudhën janar - nëntor 2010 janë raportuar së paku shtatë raste të vandalizmit ndaj varrezave ortodokse, përfshirë zhvarrimin dhe dëmtimin e një arkivoli në qytetin e Gjilanit/Gnjilane, si dhe përdhosjen dhe dëmtimin e gurëve të varreve në Deçan/Dečan, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Laplje Selo/Llapllasellë (Gračanica/Gračanicë), fshatin Lismir/Dobri Dub (komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje), Rubofc/Rabovce (komuna Lipjan/Lipljan) dhe fshatin Tomance/Tomancë (komuna Ranilug/Ranillug).

<sup>4</sup> Luteni që ta keni para sysh që për qëllim të këtij katalogu “vandalizuar” nënkupton shkatërrimin apo dëmtimin e qëllimshëm të varrezave apo pjesëve të tyre.

<sup>5</sup> Shih raportet e dorëzuara nga z. Abdelfattah Amor, Raportues Special, në seancën e 55-të të Komisionit për të Drejta të Njeriut, pika 11 (e) e agjendës së përkohshme, E/CN.4/1999/58, 11 janar 1999; dhe seancës 56-të të Komisionit për të Drejta të Njeriut, pika 11(e), E/CN.4/2000/65, 15 shkurt 2000; dhe raporti i dorëzuar nga znj. Asma Jahangir, Raportuese Speciale në seancën e 61-të të Komisionit për të Drejta të Njeriut, pika 11 (e) e agjendës së përkohshme, E/CN.4/2005/61/Add. 1, 15 mars 2005.

<sup>6</sup> Neni 18 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

<sup>7</sup> Shih letrën e Komisarit për të drejta të njeriut të Këshillit të Evropës për Ministrinë e Brendshëm të Qeverisë Franceze, 8 Tetor 2010,

<https://wcd.coe.int/ecd/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1689577&SecMode=1&DocId=1648720&Usage=2> (qasur më 21 mars 2011).

<sup>8</sup> Ligji No. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturorë, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut No. 2006/52, 6 nëntor 2006. Tërësitë specifike nuk janë identifikuar në këtë ligj. Në kohën e raportimit, organi raportues, ishte i vendosur që ta krijojë një inventar të tërësive kulturore që do të përfshihen në këtë ligj, derisa Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, ka raportuar që vetëm dy varreza janë shqyrtuar për këtë qëllim deri më tani.

<sup>9</sup> Neni 3 i Ligjit nr. 2007/30 për Vetëqeverisjen e komunave në Kosovë, 16 Tetor 2006, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45, 11 gusht 2000.

<sup>10</sup> Neni 17.1 (p), Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, 20 Shkurt 2008.

legjislacioni në “çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.”<sup>11</sup>

Ky raport përqendrohet në gjendjen dhe mirëmbajtjen e varrezave ortodokse në Kosovë. Pjesa e dytë shpalos metodologjinë e aplikuar dhe mbulimin gjeografik të vlerësimit. Pjesa e tretë përshkruan rolin dhe rëndësinë e varrezave në fenë ortodokse. Pjesa e katërt paraqet gjendjen e përgjithshme të varrezave ortodokse, ndërsa pjesa e pestë analizon faktorët që mund të ndikojnë në të. Pjesa e gjashtë shqyrton rolin e komunave, komunitetit serb të Kosovës, KOS-në dhe hisedarëve të tjerë në mirëmbajtjen e varrezave ortodokse. Raporti përfundon me rekomandimet përkatëse për autoritetet komunale dhe qendrore dhe për hisedarët e tjerë.

Raporti është publikuar krahas me katalogun e fotografive të Varrezave Ortodokse duke ofruar një pasqyrë të gjendjes fizike të varrezave ortodokse në shumicën e komunave të Kosovës.

OSBE-ja konsideron që përmirësimi i qëndrueshëm i gjendjes së varrezave ortodokse në Kosovë dhe sigurimi që ato të mos vandalizohen dhe lihen pa kujdes janë qenësore për lirinë e komunitetit serb ortodoks për t’i ushtruar të drejtat e tij fetare dhe kulturore, si dhe për krijimin e kushteve të favorshme për kthim dhe dialog ndërmjet komuniteteve.

## 2. METODOLOGJIA

OSBE-ja e ka realizuar vlerësimin e varrezave ortodokse gjatë qershorit dhe korrikut të vitit 2010. Gjatë vlerësimit janë vizituar dhe dokumentuar 392 varreza ortodokse. Për ta lehtësuar analizën dhe krahasimin, çdo varrezë është vlerësuar në bazë të nivelit të ruajtjes dhe mirëmbajtjes. Tabela e vlerësimit që është aplikuar është si në vijim:

- 1 Varreza është në **gjendje shumë të mirë**: ajo mirëmbahet, prehet bari, nuk ka mbeturina në lokacion dhe nëse gurët e varreve nuk janë dëmtuar.
- 2 Varreza është në **gjendje të mirë**: ajo nuk mirëmbahet rregullisht, nëse është e mbuluar me bar të lartë apo vegjetacion të rrallë, nëse nuk ka mbeturina në lokacion dhe nuk ka dëme apo pothuajse nuk ka dëme në gurë të varreve.
- 3 Varreza është në **gjendje relativisht të mirë**: ajo është e mbuluar me bar të lartë dhe vegjetacion të rrallë, nëse ka sasi të vogla mbeturinash në lokacion dhe nëse ka dëme në disa nga gurët e varreve
- 4 Varreza është në **gjendje të keqe**: ajo është e mbuluar me bar të lartë dhe vegjetacion të rrallë ose të dendur por gurët e varreve shihen, ka mbeturina në lokacion dhe ka dëme të rreth gjysma e gurëve të varreve.
- 5 Varreza është në **gjendje shumë të keqe**: ajo është e mbuluar me vegjetacion të dendur apo shumë të dendur që i mbulon edhe gurët e varreve, ka mbeturina në lokacion dhe, nëse gurët e varreve shihen, ka dëme pothuajse në të gjithë ta.

Përveç vlerësimit fizik të varrezave, OSBE-ja bëri intervista të strukturuar lidhur me mirëmbajtjen e varrezave me zyrtarë komunalë, përfaqësues të KOS-së dhe banorë lokalë.

---

<sup>11</sup> Neni 17.1 (s), po aty.

Derisa janë bërë të gjitha përpjekjet për t'i vizituar të gjitha varrezat e njohura ortodokse, ky raport nuk paraqet listë përfundimtare të varrezave ortodokse në Kosovë. Disa nga varrezat që janë braktisur para konfliktit të vitit 1999 nuk mund të përcaktohej vendndodhja apo të identifikoheshin ato. Varrezat tjera ishin shumë të largëta dhe pa mundësi qasjeje. Komunitatet e Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut, Zvečan/Zveçanit dhe pjesës veriore të Mitrovica/Mitrovicës nuk janë përfshirë në këtë vlerësim.<sup>12</sup>

### 3. ROLI DHE RËNDËSIA E VARREZAVE NË FENË ORTODOKSE SERBE

Të ndjerit përkujtohen në fenë ortodokse dhe varrezat luajnë një rol të rëndësishëm në disa aspekte thelbësore të këtyre përkujtimeve, nga të cilat ekzistojnë dy lloje kryesore. I pari i është Dita e Gjithëshpirtrave. Gjatë tërë vitit, KOS-ja vëzhgon katër Ditë të Gjithëshpirtrave, të cilat i dedikohen të ndjerëve dhe gjithmonë janë në ditën e shtunë. Në këto raste, familjet i kujtojnë të afërmit dhe miqtë e tyre të ndjerë. Pas shërbimeve në kishë, ata i vizitojnë varrezat, ndezin qirinj, vendosin ushqime për shpirtrat e të ndjerëve, si dhe lutën për ta. ME rastin e Ditës së Gjithëshpirtrave, familjet i pastrojnë dhe i mirëmbajnë varret e të afërmit të tyre të ndjerë. Lloji i dytë i përkujtimeve janë ato ku varrezat ortodokse vizitohen për shërbime memoriale. Në Kosovë, shërbimi i parë i këtij lloji bëhet në ditën e varrimit. Pas varrimit, të afërmit e të ndjerëve zakonisht e vizitojnë varrin çdo ditë gjatë dyzet ditëve të para.<sup>13</sup> Veç kësaj, vizitat e kombinuara me shërbime bëhen gjashtë muaj dhe një vit pas varrimit, gjithmonë të shtunave. Pas vitit të parë, familja e viziton varrin në Ditën e Gjithëshpirtrave.

Këto rituale të ndryshme që përshijnë vizita në varreza pasqyrojnë rëndësinë e varrezave në fenë ortodokse dhe për komunitetin serb të Kosovës. Shumë varreza në Kosovë, të cilat janë në gjendje shumë të keqe, ende vizitohen nga komuniteti serb i Kosovës, posaçërisht gjatë Ditës së Gjithëshpirtrave. Veç kësaj, vizita në varrezën e fshatit zakonisht është pjesë e rendit të ditës të vizitave shko-dhe-shih që bëhen nga serbët e Kosovës.<sup>14</sup>

Rrjedhimisht, varrezat e vandalizuara rëndë dhe varrezat në gjendje të dobët dërgojnë një sinjal negativ për komunitetin ortodoks në Kosovë. Shumë serbë të zhvendosur nga Kosova nuk janë në gjendje t'i vizitojnë paraardhësit e tyre sepse varrezat janë vandalizuara apo dëmtuar në atë masë të madhe sa që nuk mund të identifikon si të tilla. Një gjë e tillë është jo nxitëse për kthime të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, si dhe është pengesë për dialogun ndërmjet komuniteteve.

<sup>12</sup> Hulumtimet preliminare të bëra nga OSBE-ja tregojnë që varrezat ortodokse që gjenden në veri të lumit Ibër nuk kanë ndonjë problem të dukshëm për sa i përket gjendjes apo përdorimit. Kjo është për shkak të faktit që më pak serbë të Kosovës ishin zhvendosur nga kjo zonë pas konfliktit të vitit 1999 dhe kishte mbetur një shumicë e serbeve të Kosovës. Prandaj, këto varreza nuk janë trajtuar.

<sup>13</sup> Familjarët e largët dhe miqtë e të ndjerëve i vizitojnë zakonisht varret në tri ditë e para, në ditën e shtatë dhe të dyzetë.

<sup>14</sup> Vizitat shko-dhe-shih ua mundësojnë personave të zhvendosur që të marrin informata të dorës së parë lidhur me gjendjen e vendit të tyre të prejardhjes dhe të bashkëbisedojnë drejtpërdrejt me komunitetin pranues ashtu që të marrin vendime të mirinformuara lidhur me kthimin apo zgjidhje tjera të qëndrueshme. Ata ftohen që t'i vizitojnë ish shtëpitë e tyre dhe të takohen me fqinjët e tyre, pjesëtarët e komunitetit dhe institucionet lokale si dhe të diskutojnë për çështje me interes të posaçëm, siç janë asistencë për rindërtimin e shtëpive, punësimi dhe mundësitë për krijimin të të ardhurave, siguria dhe liria e lëvizjes, mirëqenia sociale dhe pensionet, arsimit dhe shërbimet tjera publike. Shih Doracak i ripunuar për Kthim të qëndrueshëm të UNMIK/IPVQ, korrik 2006, [http://www.unmikonline.org/srsg/orc/documents/Manual\\_ENG.pdf](http://www.unmikonline.org/srsg/orc/documents/Manual_ENG.pdf) (qasur më 21 mars 2011).

#### 4. GJENDJA FIZIKE E VARREZAVE ORTODOKSE

OSBE-ja gjeti se gjendja fizike e varrezave ortodokse në Kosovë është përgjithësisht e dobët. Gjithsej janë vlerësuar 392 varreza ortodokse dhe 229 prej tyre janë gjetur të jenë në gjendje të keqe apo shumë të keqe (58% nga gjithsej). Vetëm 46 varreza (12%) janë gjetur të jenë në gjendje shumë të mirë dhe 83 tjera (21%) në gjendje të mirë. 24 varreza (9%) janë gjetur të jenë në gjendje relativisht të mirë.<sup>15</sup>

Disa varreza janë vandalizuar në vitin 1999 dhe 2004 dhe shenjat e dëmtimit janë ende të dukshme, ku gurët e varreve janë rrëzuar apo janë thyer. Shumë varreza afër fshatrave ku serbët e Kosovës janë zhvendosur nuk janë vandalizuar por janë në gjendje shumë të keqe për shkak të lënies pas dore dhe prishjes. Ato varreza janë të mbuluara me vegjetacion dhe, në disa raste, të mbuluara me mbeturina.

Disa prej varrezave më të dëmtuara janë riparuar apo restauruar pjesërisht nga Komisioni për Implementimin e Rindërtimit të Tërësive Fetare Ortodokse (KIR). Varreza të tjera janë riparuar dhe restauruar nga vetë komuniteti serb i Kosovës, disa herë me financim të komunave dhe/apo Ministrisë për komunitete dhe kthim, Ministrisë së Republikës së Serbisë për Kosovë dhe Metohi, dhe OSBE-së.

Tabela më poshtë paraqet një ndarje tabelore të gjendjes së varrezave ortodokse sipas komunës (1 = shumë mirë; 2 = mirë; 3 = relativisht mirë; 4 = keq; 5 = shumë keq).

*Tabela. 1. Gjendja e varrezave ortodokse sipas komunave*

Rajoni	Komuna	Gjithsej	1	2	3	4	5
<b>Gjilan/Gnjilane</b>	Ferizaj/Uroševac	18	-	1	3	1	13
	Gjilan/Gnjilane	10	1	3	1	1	4
	Hani i Elezit/Đeneral Janković	1	-	-	-	1	-
	Kaçanik/Kaçanik	3	-	-	-	-	3
	Kamenicë/Kamenica	19	-	10	6	1	2
	Vrbovac/Klokot/Kllo kot - Vërbovc	5	2	3	-	-	-
	Novo Brdo/Novobërdë	24	3	12	7	-	2
	Parteš/Partesh	4	3	-	1	-	-
	Ranilug/Ranillug	15	5	8	2	-	-
	Štrpce/Shtërpçë	18	1	17	-	-	-
Viti/Vitina	16	-	2	1	5	8	
<b>Prizren</b>	Prizren	17	2	4	3	1	7
	Malishevë/Mališevo	1	-	-	-	-	1
	Rahovec/Orahovac	10	1	2	1	-	6
	Suharekë/Suva Reka	9	-	-	-	-	9
<b>Pejë/Peć</b>	Deçan/Dečane	5	-	-	-	-	5
	Gjakovë/Đakovica	4	-	-	-	1	3

<sup>15</sup> Shih “Katalog i Fotografive – Varrezat Ortodokse në Kosovë”, Misioni i OSBE-së në Kosovë, qershor 2011.

	Istog/Istok	29	2	3	2	3	19
	Klinë/Klina	25	-	1	4	-	20
	Pejë/Peć	13	2	1	1	3	6
<b>Prishtinë/ Priština</b>	Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	7	1	1	-	1	4
	Glogovc/Glogovac	4	-	-	-	-	4
	Gračanica/Gračanicë	19	15	3	-	1	-
	Lipjan/Lipljan	19	-	2	-	2	15
	Obiliq/Obilić	9	4	-	-	1	4
	Podujevë/Podujevo	42	1	-	1	1	39
	Prishtinë/Priština	13	1	5	-	2	5
	Shtime/Štimlje	5	-	-	-	-	5
<b>Mitrovicë/ Mitrovica</b>	Mitrovicë/Mitrovica South	3	-	-	1	-	2
	Skenderaj/Srbica	10	1	2	2	1	4
	Vushtrri/Vučitrn	15	1	3	-	-	11
<b>Total</b>		<b>392</b>	<b>46</b>	<b>83</b>	<b>36</b>	<b>26</b>	<b>201</b>

## 5. FAKTORËT QË KONTRIBUOJNË NË GJENDJEN E VARREZAVE ORTODOKSE

### 5.1 Gjendja e varrezave ortodokse sipas afërsisë apo largësisë nga komuniteti serb i Kosovës

Gjatë kryerjes së vlerësimit, OSBE-ja ka marrë shënime nëse varrezat e studiuara ishin në afërsi të fshatrave të serbëve të Kosovës, apo në afërsi të fshatrave ku nuk ka komunitet serb të Kosovës<sup>16</sup> (shih tabelën më poshtë). Gjetjet tregojnë se shumica e varrezave që gjenden në afërsi të fshatrave të banuara me serbë të Kosovës (127 nga 193 varreza) janë në gjendje të mirë apo shumë të mirë. Si krahasim, 185 nga 199 varreza në afërsi të fshatrave ku nuk ka komunitet serbë të Kosovës janë në gjendje të keqe apo shumë të keqe, dhe vetëm dy prej tyre janë në gjendje të mirë.<sup>17</sup>

Tabela 2. Gjendja e varrezave sipas afërsisë së tyre me komunitetin serb të Kosovës.

Gjendja e varrezave	Gjithsej	1	2	3	4	5
Varrezat ngjitur me fshatrat e banuar me serbë të Kosovës	193	46	81	24	15	27
Varrezat ngjitur me fshatrat pa komunitet serb të Kosovës	199	0	2	12	11	174

<sup>16</sup> Kjo i referohet si fshatrave ku jeton komuniteti serb i Kosovës i zhvendosur si rezultat i konfliktit të vitit 1999 ashtu edhe fshatrave që janë pa komunitetin serb të Kosovës qysh para konfliktit.

<sup>17</sup> Duhet theksuar se janë dy varreza ngjitur me Manastirin e Deviçit/Dević (Komuna e Skenderajt/Srbica) të cilat kanë qenë në mbrojtje të KFOR-it që nga viti 1999 dhe mirëmbahen nga motra nderi që jetojnë aty. Varreza që gjendet brenda kufijve të manastirit është shkatërruar gjatë trazirave të marsit 2004, por është riparuar dhe restauruar nga KIR-ja në vitin 2007.



## Varrezat ngjitur me fshatra të banuara me serbë të Kosovës



## Varrezat ngjitur me fshatra të pabanuara me serbë të Kosovës



Sa i përket lidhjes ndërmjet afërsisë së komunitetit serb të Kosovës dhe gjendjes së varrezave, OSBE-ja ka vërejtur tre faktorë që mund të të kenë lidhje me këtë. Së pari, ka më pak gjasa që të vandalizohen varrezat ortodokse që gjenden në komuna apo fshatra ku serbët e Kosovës janë shumicë<sup>18</sup>, për shkak të pranisë dhe kujdesit që iu kushtohet varrezave nga popullata serbe e Kosovës që jeton në Kosovë. Së dyti, pasi që një varrezë të dëmtohet apo shkatërrohet, ajo ka nevojë për burime të konsiderueshme për t'u riparuar dhe restauruar. Prandaj, aty ku nuk ka komunitet serb të Kosovës në afërsi të varrezave të dëmtuara për ta përkrahur riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre, gjendja e tyre shpesh është përkeqësuar edhe më shumë me kalimin e kohës.<sup>19</sup> Së treti në mungesë të çfarëdo mirëmbajtjeje nga institucionet e Kosovës, komuniteti lokal ka kontribuar shumë në riparimin dhe mirëmbajtjen e varrezave ortodokse. Rrjedhimisht, aty ku komuniteti është i zhvendosur nuk ka kush ta merr këtë përgjegjësi.

### 5.2 Gjendja e varrezave ortodokse sipas afërsisë apo largësisë nga fshati

OSBE-ja ka gjetur se prej 310 varrezave që gjenden brenda apo në afërsi të një fshati, 108 (35%) janë në gjendje të mirë apo shumë të mirë dhe 173 (56%) janë në gjendje të keqe apo shumë të keqe. Si krahasim, vetëm 22 (27%) prej 82 varrezave që gjenden shumë larg fshatrave janë në gjendje të mirë apo shumë të mirë, dhe 55 (67%) janë në gjendje të keqe apo shumë të keqe (shih tabelën më poshtë).

Prandaj, varrezat që janë gjeografikisht larg nga zonat e banuara (p.sh. nga qytetet apo fshatrat) kanë tendencë që të jenë në gjendje më të keqe se ato që janë ngjitur me zonat e banuara pasi që ato të parat janë më të vështira për tu mirëmbajtur. Mirëpo, ky faktorë nuk

<sup>18</sup> Për shembull komunat e Gračanica/Graçanicës, Štrpce/Shtërpçës dhe Klokot-Vrbovac/Klllokotit-Vërboc


<sup>19</sup> Shih nenin 6.1 më poshtë për diskutim lidhur me mbështetjen financiare nga komunat e banuara me serbë të Kosovës në krahasim me zonat ku nuk jetojnë serbët e Kosovës.

duhet të mbivlerësohet pasi që shumë varreza që gjenden ngjitur me zonat e banuara janë gjithashtu në gjendje të keqe në ato vende ku komuniteti serb i Kosovës është i zhvendosur.


Tabela 3. Gjendja e varrezave sipas afërsisë së tyre me fshatin.

Gjendja e varrezave	Gjithsej	1	2	3	4	5
Varrezat që gjenden në fshat	174	24	29	17	16	88
Varrezat që gjenden në afërsi të një fshati	136	21	34	12	4	65
Varrezat që gjenden larg një fshati	82	2	20	5	8	47


Varrezat që gjenden në fshat



Varrezat që gjenden në afërsi të një fshati



Varrezat që gjenden larg një fshati



## 6. MIRËMBAJTJA E VARREZAVE ORTODOKSE

### 6.1. Përgjegjësitë e komunave

### 6.1.1 Dispozitat ligjore

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2007/30 ngarkon komunat me “sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave”<sup>20</sup>. Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale përmend vetëm “ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike”<sup>21</sup>, por gjithashtu përcakton që komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacion për “çfarëdo çështje që nuk është shprehimisht e përjashtuar nga kompetencat e tyre apo që i është ngarkuar ndonjë autoriteti tjetër.”<sup>22</sup>

Obligimi për mirëmbajtjen e varrezave në nivel lokal shpesh përcaktohet me statut dhe/ose me një rregullore të komunës. Në 13 prej 33 komunave të anketuara, statuti i komunës përcakton në hollësi përgjegjësinë e komunës për mirëmbajtjen e varrezave. Ndërsa në 11 statute të komunës theksohet, në mënyrë të nënkuptueshme, përgjegjësia e komunës për mirëmbajtjen e varrezave, si për shembull përgjegjësia e komunës për mirëmbajtjen e hapësirës publike apo të vendeve të trashëgimisë kulturore. Sa i përket rregulloreve, 22 komuna kanë miratuar një rregullore për mirëmbajtjen e varrezave. Komuna e vetme që nuk përcakton me statut apo me rregullore mirëmbajtjen e varrezave është ajo e Štrpce/Shtërpçës.<sup>23</sup> Megjithatë, të gjitha varrezat ortodokse të evidentuara në komunën e Štrpce/Shtërpçës që ka komuniteti të serbëve të Kosovës janë në gjendje të mirë.

Aty ku statuti dhe/ose rregullorja e komunës përcakton përgjegjësi kundrejt varrezave, atëherë zakonisht ngarkohet një organ komunal për mbikëqyrjen e gjendjes së varrezave dhe mirëmbajtjen e tyre. Në shumë komuna, ky organ komunal është Drejtoria për Shërbime Publike.<sup>24</sup> Në komunën e Lipjanit/Lipljan, përgjegjësia për varrezat i është ngarkuar Drejtorisë për Urbanizëm dhe Kadastër, ndërsa në komunat e Prishtinës/Priština dhe Mitrovicës/Mitrovica kjo përgjegjësi i është ngarkuar Drejtorisë së Inspektimeve. Disa rregullore ose statute komunale përcaktojnë transferimin e përgjegjësisë drejtpërdrejt te një kompani e shërbimeve publike (p.sh., në komunën e Shtimes/Štimlje dhe atë të Fushë Kosovës/Kosovo Polje).

### 6.1.2 Buxheti

Me gjithë obligimet ligjore të komunave të përcaktuara shprehimisht, megjithatë u ndanë burime të kufizuara financiare për mirëmbajtjen e varrezave, si ortodokse ashtu edhe jo-ortodokse. Në vitin 2010, vetëm shtatë komuna ndanë buxhet për pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave<sup>25</sup> ndërsa në katër prej tyre pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave ishte pjesë e planit të përgjithshëm për hapësirën publike apo për mbrojtjen e mjedisit, pra nuk kishte ndonjë linjë buxhetore të përcaktuar vetëm për varrezat. Për shembull, komuna e Prishtinës/Priština ndau 250 000 euro për mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike, duke

<sup>20</sup> Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30, i datës 16 tetor 2006, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45 për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, i datës 11 gusht 2000.

<sup>21</sup> Neni 17.1 (p) i Ligjit nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale, i datës 20 shkurt 2008.

<sup>22</sup> Neni 17.1 (s), po aty.

<sup>23</sup> Shih Shtojcën I mbi një pasqyrë të statuteve dhe të rregulloreve komunale për mirëmbajtjen e varrezave.

<sup>24</sup> Emri i kësaj drejtorie ndryshon nga komuna në komunë: p.sh. drejtoria e urbanizmit, shërbimeve publike dhe mjedisit (në komunën e Podujevës/Podujevo), drejtoria e shërbimeve publike, bujqësisë, pylltarisë dhe emergjencave (në komunën e Gračanica/Gračanicës), drejtoria e mjedisit, shërbimeve publike, bujqësisë dhe zhvillimit rural (në komunën e Prizrenit) dhe drejtoria e punëve komunale dhe shërbimeve teknike (në komunën e Pejës).

<sup>25</sup> Këto komuna janë: Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Obiliq/Obilić, Prishtinë/Priština, Rahovec/Orahovac dhe Vushtrri/Vučitrn.

përfshirë edhe varrezat, ndërsa komuna e Gjilanit/Gnjilane ndau 100 000 euro për mirëmbajtjen e parkut të qytetit dhe varrezave. Në komunën e Rahovecit/Orahovac, mirëmbajtja e varrezave u përfshi në buxhetin prej 45 000 euro të ndarë për planifikim urban dhe inspektim. Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje ndau 15 000 euro për mirëmbajtjen e mjedisit, duke përfshirë mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e varrezave. Mungesa e një linje specifike të buxhetit për varrezat nënkupton që nuk ka garanci që ndonjëri nga fondet e ndara për hapësira publike apo për mbrojtje të mjedisit do të përdoret për varreza.

Në vitin 2010, vetëm tri komuna kishin linja të veçanta buxhetore për mirëmbajtjen e varrezave. Komuna e Mitrovicës/Mitrovica dhe komuna e Vushtrrisë/Vučitrn ndanë 30 000 euro, përkatësisht 6 000 euro për mirëmbajtjen e varrezave ortodokse dhe jo-ortodokse. Komuna e Obiliqit/Obilić ndau 10 000 euro vetëm për pastrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave ortodokse.

Komunat tjera ndanë fonde në mënyrë *ad hoc*. Për shembull, komuna e Prizrenit ndau 4 500 euro për pastrimin e varrezave ortodokse të qytetit. Në vitin 2007, komuna e Istogut/Istok ndau rreth 2 000 euro për vendosjen e rrethojës për varrezën ortodokse në fshatin Zhakovë/Žakovo, pasi që një shkarje toke e shkatërroi pjesën e poshtme të varrezës. Në komunat e tjera (p.sh., në Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina dhe Klinë/Klina) u siguruan fonde të vogla *ad hoc* gjatë viteve të fundit për pastrimin apo vendosjen e rrethojave në varrezat ortodokse, si përgjigje ndaj kërkesave të komunitetit serb të Kosovës. Pastrimi dhe puna për vendosjen e rrethojës u bë zakonisht nga pjesëtarët vullnetarë të komunitetit serb në bashkëpunim me KOS-në.

Edhe në komunat që ndajnë buxhet për mirëmbajtjen e varrezave (qoftë në mënyrë të veçantë apo si pjesë e një buxheti më të përgjithshëm), shumë varreza ortodokse mbeten në gjendje të keqe pasi që fondet e ndara përdoren vetëm për një numër të vogël të varrezave ortodokse brenda komunës (p.sh. vetëm për ato që gjenden në qytet e jo për ato që gjenden në fshatra). Për më tepër, në hartimin e buxhetit merret parasysh vetëm pastrimi dhe jo ndonjë riparim thelbësor i gurëve të varreve që janë dëmtuar rëndë. Për shembull, komuna e Prishtinës/Priština ka angazhuar një kompani publike të mirëmbajtjes për t'i pastruar varrezat e qytetit katër herë në vit, duke përfshirë këtu varrezën ortodokse ngjitur me Kishën e Shën Nikollës (që u shkatërrua në vitet 1999 dhe 2004) dhe një varrezë me pjesët ortodokse, katolike dhe çifute. Megjithatë që të dy varrezat janë në gjendje të keqe.<sup>26</sup> Komuna e Mitrovicës/Mitrovica ka angazhuar një kompani publike të mirëmbajtjes për ta pastruar dy herë në vit varrezën ortodokse që gjendet në hyrje të qytetit. Megjithatë varreza është në gjendje shumë të keqe dhe shumë prej gurëve të varreve janë të thyer apo të rrëzuar.

Përfundimisht, përderisa të gjitha komunat – përveç njëjës – përcaktojnë me statut dhe/ose me rregullore komunale përgjegjësinë për mirëmbajtjen e varrezave, shumica dështojnë në përmbushjen e obligimeve të tyre duke mos ndarë buxhet për këtë qëllim. Për më tepër, buxheti që u nda në ato pak komuna apo aty janë siguruar fonde *ad hoc* për projekte specifike të mirëmbajtjes, ishin të pamjaftueshme për mirëmbajtjen dhe/ose riparimin e shumë varrezave ortodokse që gjenden në territorin e këtyre komunave. Gjithashtu duhet të theksohet që sigurimi i fondeve për mirëmbajtjen e varrezave ka ndodhur vetëm në komunat që janë të banuara me serb të Kosovës.

---

<sup>26</sup> Varreza ngjitur me Kishën e Shën Nikollës u riparua pjesërisht nga KIR në vitin 2007.

## **7. ROLI I AKTERËVE TJERË**

### **7.1. Kontributet e komunitetit serb të Kosovës**

Gjatë vlerësimit të vet OSBE ka vërejtur që komuniteti serb i Kosovës ka luan rolin kryesor për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e varrezave ortodokse, duke mobilizuar vullnetarë lokalë për kryerjen e punëve të pastrimit dhe të mirëmbajtjes p.sh., në qytetet dhe/ose fshatrat e komunave të Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Lipjanit/Lipljan, Obiliqit/Obilić, Prishtinës/Priština dhe Štrpce/Shtërpçës.

Në fshatrat Shalinoc/Šaljnovica, Sinejë/Sinaje, Tomoc/Tomance dhe Tuçep/Tučep (komuna e Istogut/Istok), dhe në fshatrat Brestovik/Brestovik, Lëvoshë/Ljevoša, Sigë/Siga si dhe në qytetin e Pejës/Peć (komuna e Pejës/Peć), pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave ortodokse është bërë nga ana e të kthyerve serbë të Kosovës.

Në komunat e banuara me serbë të Kosovës, puna e pastrimit dhe mirëmbajtjes zakonisht kryhet rregullisht. Ndërsa në komunat tjera, këto aktivitete ndërmerren kryesisht para ndonjë feste fetare ortodokse ose para vizitave shko-dhe-shih të të kthyerve potencialë apo refugjatëve dhe personave të tjerë të zhvendosur.<sup>27</sup>

### **7.2. Kontributet e Kishës Ortodokse Serbe (KOS)**

KOS-i dhe priftërinjtë e vetë lokal bashkëpunojnë ngushtë me komunitetin serb të Kosovës për mirëmbajtjen e varrezave ortodokse. Në të vërtetë, kishat vendore janë ato që e mobilizojnë zakonisht komunitetin serb të Kosovës dhe mirëmbajtja e varrezave kryhet rrallë pa përfshirjen e priftit lokal. Disa kisha e punësojnë gjithashtu një kujdestar me qëllim të mirëmbajtjes së varrezës.

Varrezat që gjenden brenda komplekseve të manastireve ortodokse (p.sh. Manastiri i Gračanica/Gračanicës, Manastiri i Deviç/Deviçit në komunën e Skenderajt/Srbica dhe Manastiri i Zoqishtës/Zočiste në komunën e Rahovecit/Orahovac) apo në afërsi të tyre mirëmbahen nga murgeshat apo murgjit që jetojnë aty.

### **7.3. Kontributi i hisedarëve tjerë**

#### **7.3.1 Ministria për Komunitete dhe Kthim**

Ndonëse ofrimi dhe mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave publike bie në mandatin e komunave, Ministria për komunitete dhe kthim ka siguruar mbështetje financiare për riparimin dhe restaurimin e disa varrezave ortodokse në Kosovë.

Gjatë dy viteve të kaluara, ajo financoi rindërtimin e një rrethojë të një varrezë në komunën e Prishtinës/Priština, në të cilën gjenden gurët e varreve ortodokse, katolike dhe çifute. Përveç kësaj, ajo mbështeti financiarisht pastrimin e pjesës ortodokse të varrezës së qytetit të Prizrenit. Në vitin 2010, ministria i dha mbështetje financiare komunitetit serb të Kosovës që jeton në komunën e Gjilanit/Gnjilane për pastrimin dhe restaurimin e pjesëshëm të varrezës

---

<sup>27</sup> Vlerësimi i OSBE-së tregon që në disa vitet e fundit ka pasur vizita shko dhe shih në varrezat ortodokse, për shembull në fshatin Miradi e Epërme/Gornje Dobrovo (komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje), në fshatrat Balloc/Balovac, Zakut dhe në qytetin e Podujevës/Podujevo (komuna e Podujevës/Podujevo), Sërbicë e Epërme/Gornja Srbica village (Komuna e Prizrenit), fshatin Zoqishtë/Zočiste dhe qytetin e Rahovecit/Orahovac (komuna e Rahovecit/Orahovac), dhe fshatrat Mushtisht/Mušutište dhe Reç/Reçane (komuna e Suharekës/Suva).

ortodokse të qytetit, si dhe për ndërtimin e një kishëze të re në varrezën ortodokse të fshatit Koretište/Koretishtë (komuna e Novo Brdo/Novobërdës).

### **7.3.2 Komisioni për implementimin e rindërtimit për tërësitë religjioze ortodokse serbe në Kosovë<sup>28</sup>**

KIR-ja i cili u themelua në vitin 2005 bënë planifikimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të punëve të rindërtimit në 34 tërësi religjioze ortodokse që u dëmtuan gjatë trazirave të marsit të vitit 2004.

Në vitet e fundit, KIR-ja riparoj apo restauroi pjesërisht varrezat e shkatërruara apo të dëmtuara rëndë në fshatin Talinoc i Muhaxherëve/Muhadžer Talinovac dhe në qytetin e Ferizajt/Uroševac (komuna e Ferizajt/Uroševac), në qytetin e Gjakovës/Đakovica, në fshatin Bellopojë/Belo Polje (komuna e Pejës/Peć), në qytetin e Prishtinës/Priština si dhe në Manastirin e Deviçit/Devič (komuna e Skenderajt/Srbica).

### **7.3.3 Ministria për Kosovë dhe Metohi e Republikës së Serbisë**

Në muajin tetor të vitit 2009, Ministria për Kosovë dhe Metohi e Republikës së Serbisë shpalli një plan trevjeçar për pastrimin dhe restaurimin e varrezave ortodokse në Kosovë. Në vitin 2010, në bazë të këtij plani, ministria siguroi fonde për pastrimin apo rehabilitimin e varrezave ortodokse në qytezën e Novo Brdo/Novobërdës, në fshatin Zoqishtë/Zočiste (komuna e Rahovecit/Orahovac), në fshatin Mushtisht/Mušutište (komuna e Suharekës/Suva Reka) si dhe në qytetin e Vushtrrisë/Vučitrn.

## **8. AKTIVITETET E MISIONIT TË OSBE-së NË KOSOVË**

Si pjesë e mandatit të saj, OSBE-ja ka bërë përpjekje për të kontribuar në kthim të qëndrueshëm përmes përmirësimit të mjedisit fetar dhe kulturor në zonat potenciale të kthimit, përfshirë sigurimin e financimit për riparim të varrezave ortodokse. Në këtë mënyrë në vitin 2010 dhe 2011, OSBE-ja siguroi fonde për riparimin apo pastrimin dhe vendosjen e rrethojave për varrezat ortodokse në qytetin e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, në fshatrat Dragoljevc/Dragoljevac Muzhevinë/Muževina (komuna e Istogut/Istok), në fshatin Staro Gracko/Grackë e Vjetër (komuna e Lipjanit/Lipljan), në fshatrat Drajcici/Drajçiq, Novake/Novak dhe Sërbicë e Poshtme/Donja Srbica (komuna e Prizrenit/Prizren) si dhe në fshatin Zoqishtë/Zočiste (komuna e Rahovecit/Orahovac). OSBE-ja po ashtu pati një rol aktiv në lehtësimin e dialogut ndërmjet komunave, komunitetit serb të Kosovës dhe KOS-së për çështjen e mirëmbajtjes së varrezave ortodokse.

## **9. PËRFUNDIM**

Ky raport siguron një vlerësim të përgjithshëm të gjendjes së varrezave ortodokse serbe në bazë të të dhënave të mblledhura nga OSBE-ja gjatë periudhës qershor – korrik 2010. Si rezultat i këtij vlerësimi, OSBE-ja vizitoi 392 varreza ortodokse dhe gjeti që shumica prej tyre ishin në gjendje të keqe apo shumë të keqe.

Për më tepër, OSBE-ja ka identifikuar që faktori kryesor që është parë se është i ndërlidhur me gjendjen së keqe të varrezave ortodokse është mungesa e komunitetit serb të Kosovës në afërsi të atyre varrezave. Së pari përgjegjësinë kryesore për pastrimin dhe mirëmbajtjen e

---

<sup>28</sup> Shih fusnotën 2 më lart

varrezave e bartin të afërmit e të ndjerëve, apo komuniteti në përgjithësi. Në vendet ku komuniteti serb i Kosovës është i zhvendosur, nuk ka askush që t'i mirëmbajë varrezat. Së dyti, komunat, në të cilat nuk jeton komuniteti serb i Kosovës, në përgjithësi ishin më pak të gatshme apo më pak të afta për të siguruar burime për mirëmbajtjen e varrezave ortodokse.

Përkundër obligimeve të qarta ligjore të komunës për mirëmbajtjen e varrezave - atyre ortodokse dhe jo-ortodokse - që përcaktohen me ligj dhe me statutet dhe/ose rregulloret komunale, vetëm shtatë komuna ndanë buxhet për këtë punë në vitin 2010. Përveç kësaj, këto buxhete në përgjithësi u shfrytëzuan vetëm për disa varreza ortodokse (dhe jo për të gjitha varrezat ortodokse të komunave) dhe vetëm për pastrimin e tyre e jo për ndonjë riparim qenësor të gurëve të varreve të dëmtuara rëndë.

Derisa obligimi për mirëmbajtjen e varrezave i përket komunave, OSBE-ja ka vërejtur që, në praktikë komuniteti serb i Kosovës dhe KOS-ja kanë luajtur rolin kryesor për mirëmbajtjen dhe riparimin e varrezave ortodokse në Kosovë. KIR-ja, Ministria për Komunitete dhe Kthim e Kosovës, Ministria për Kosovë dhe Metohi e Republikës së Serbisë si dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë kontribuan duke financuar punët e riparimit.

Në përgjithësi, shumica e varrezave ortodokse në Kosovë janë vlerësuar të jenë në gjendje të keqe dhe kanë nevojë për intervenim. OSBE-ja konsideron që përmirësimet afatgjata dhe të qëndrueshme të gjendjes së varrezave ortodokse si dhe sigurimi që ato të mos shkatërrohen apo vandalizohen, do të ofronin një mjedis më të favorshëm për kthim dhe për dialogun ndërmjet komuniteteve.

## **10. REKOMANDIMET**

### **Për komunat:**

- Të caktojnë përgjegjësi të qarta lidhur me mirëmbajtjen e varrezave, përfshirë varrezat ortodokse;
- Të ndajnë më shumë burime financiare dhe t'i ndajnë me destinacion të veçantë për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e varrezave ortodokse, posaçërisht në ato komuna ku jeton komuniteti serb i Kosovës dhe/ose të cilat janë vend potencial për kthim ku marrëdhëniet ndëretnike dhe kthimet e jo-shqiptarëve mund të ndikohen pozitivisht me mirëmbajtjen e varrezave;
- Të sigurohet konsultim me komunitetin serb të Kosovës dhe me përfaqësuesit lokalë të KOS-it për mënyrat e bashkëpunimit për mirëmbajtjen apo përmirësimin e qëndrueshëm të gjendjes së varrezave ortodokse;

### **Për qeverinë:**

- Nëpërmjet Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, të vazhdojë inkurajimin dhe mbështetjen e komunave për përmirësimin e gjendjes së varrezave ortodokse posaçërisht në vendet potenciale për kthim;

### **Për bashkësinë ndërkombëtare:**

- Të inkurajojë komunat për investimin e më shumë burimeve për mirëmbajtjen e gjendjes së varrezave ortodokse;
- Kurdo që është e mundshme të mbështesë projektet për riparimin e varrezave ortodokse të cilat janë dëmtuar rëndë.

**SHTOJCA I: Pasqyrë e statuteve dhe e rregulloreve komunale për mirëmbajtjen e varrezave**

Komuna	Është përfshirë mirëmbajtja e varrezave në statut?		Rregullorja për mirëmbajtjen e varrezave
	Shprehimisht	E nënkuptuar	
<b>Rajoni i Gjilanit/Gnjilane</b>			
Ferizaj/Uroševac	--	✓	2007
Gjilan/Gnjilane	--	✓	2005
Hani i Elezit/Đeneral Janković	✓	--	Jo
Kaçanik/Kaçanik	✓	--	Jo
Kamenicë/Kamenica	--	✓	2006
Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc	✓	--	Jo
Novo Brdo/Novobërdë	✓	--	2005
Parteš/Partesh	Nuk janë në dispozicion (N.A.)	N.A.	N.A.
Ranilug/Ranillug	--	✓	Jo
Štrpce/Shtërpçë	Jo	Jo	Jo
Viti/Vitina	--	✓	2005
<b>Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica</b>			
Leposavić/Leposaviq	Nuk ishte pjesë e vlerësimit (NIPV)	NIPV	NIPV
Mitrovicë jugore	✓	--	2006
Skenderaj/Srbica	✓	--	Jo
Vushtrri/Vučitrn	Jo	Jo	2006
Zubin Potok	NIPV	NIPV	NIPV
Zvečan/Zvečan	NIPV	NIPV	NIPV
<b>Rajoni i Pejës/Peć</b>			
Deçan/Deçane	Jo	Jo	2007
Gjakovë/Djakovica	✓	--	2006
Istog/Istok	✓	--	2006
Junik	(N.A.)	N.A.	N.A.
Klinë/Klina	Jo	Jo	2006
Pejë/Peć	Jo	Jo	2005
<b>Rajoni i Prishtinës/Priština</b>			
Fushë Kosovë/Kosovo Polje	--	✓	2005
Gllgovc/Glogovac	--	✓	Jo
Gračanica/Gračanicë	✓	--	Jo
Lipjan/Lipljan	--	✓	2006
Obiliq/Obilić	--	✓	2006
Podujevë/Podujevo	✓	--	2007
Prishtinë/Priština	✓	--	2006
Shtime/Štimlje	✓	--	2006
Dragash/Dragaš	Jo	Jo	2005
Malishevë/Mališevo	--	✓	2006
Mamuša/Mamushë/Mamuša	N.A.	N.A.	N.A.
Prizren	✓	--	2006
Rahovec/Orahovac	✓	--	2008
Suharekë/Suva Reka	--	✓	2006